Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01 – 11(
Datë: 27.02.20

Në mbështetje të neneve 4, dhe 23, të Ligjit nr.03/L-189 për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës, të neneve 6 dhe 16 të Ligjit nr. 03/L-060 për Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ (MASHT) nr. 35/2014 - Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve në mbledhjen e mbajtur me datë 22.12.2016 nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Akreditohet dhe validohet e Qendrës së Trajnimit "DTC Diakonie" në Mitrovicë, për periudhën 31.12.2016 deri 31.12.2019 për të ofruar kualifikime të validuara ne KKK:

   1.1 Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit; Niveli III sipas KKK
   1.2 Instalues Elektrik; Niveli i KKK-së: (III)
   1.3 Instalues i ngrohjes qëndrore; Niveli i KKK-së: (III)

2. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin e Instalues i Ujësjellësit dhe Kanalizimit:
   2.1Hartimi i planit të biznesit (plani i zhvillimit)
   2.2 Hartimi i politikave dhe proceduarve për proceset e punës që zhvillohen në Qendrën e Trajnimit Diakonia
   2.3 Hartimi i planit për trajnimin e personelit (pjesë e planit të biznesit).

2.4 Përshkrimi i vendit të punës për të punësuarit në Qendrën e Trajnimit.

2.5 Përgatitja e katalogut të trajnimeve-profileve që ofrohen në Qendër.

2.6 Përgatitja e plani vjetor (planit të punës) për ofrimin e trajnimeve.

2.7 Hartimi i testeve për vlerësim të pjesës praktike.

2.8 Zhvillimi i formave për monitorimin e Trajnerëve.

2.9 Sigurimi i një hapësire për ruajtjen e materialit shpenzues.

2.10 Regjistrimi i hyrje daljes së materialit nga depoja.

2.11 Përgatitja e orarit javor të trajnimit për pjesëmarrësit në trajnim.

2.12 Zbatimi i masave të sigurisë dhe pajisjeve mbrojtëse në punë duke përfshirë edhe shenjat mbi daljen emergjente.

2.13 Zbatimi i plotë i procedurave të sigurisë dhe mjeteve mbrojtëse në punë.

2.14 Trajneri nuk posedon profesionin adekuat, i njëjti është me profesion jurist i diplomuar ka nevoje për trajnime shtese në metodologjinë e mësimdhënies dhe trajnime për kualifikimin brenda ose jashtë vendit.

2.15 Vajtja/ardhja e kandidateve duhet të jetë edhe e nënshkruar nga kandidatët

3. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin e Instalues Elektrik :

3.1 Kandidatët të nënshkruhen personalisht dhe për çdo ditë në fleta të veçanta.

3.2 Testimi të mbahet në fund të secilit modul

3.3 Të zhvillohet procedurë për përzgjedhjen e barabartë dhe vlerësimin e personave me nevoja të veçanta.

3.4 Testi hyrës të jetë më specifik dhe të mundësojë përcaktimin e njohurive dhe shkathtësive ekzistuese të kandidatit e që lidhen me profilin

3.5 Pjesa teorike dhe praktike të organizohen ndaras dhe testi praktik të jetë punë praktike në panelet montuese

3.6 Të zhvillohet procedurë/politikë e cila parasheh kushtet, kriteret dhe afatet rreth mundësisë së ritestimit për kandidatët të cilët nuk e kalojnë me sukses modulin/kualifikimin

3.7 Të zhvillohet procedurë/politikë për njohjen e kredive nga institucione të tjera

3.8 Të përditësohet paketa mësimore, ose edhe të shikohet mundësia e shfrytëzimit të paketës mësimore nga institucione të tjera që kanë profil të ngjashëm

3.9 Të zhvillohet procedurë/politikë për menaxhimin e incidenteve

3.10 Salla të pajiset me kuti të ndihmës së parë dhe me pajisjet përcjellëse të nevojshme

3.11 Të krijohet lista e pajisjeve brenda laboratorit dhe të dihet saktë se cili panel me çfarë disponon

3.12 Koordinatorja për sigurimin e cilësisë të mbajë proces dhe të evidentojë takimet e zhvilluara me personelin e Qendrës për sigurimin dhe ngritjen e cilësisë

3.13 Paketa mësimore t'u jepet në shfrytëzim kandidatëve gjatë kohës së trajnimit dhe të mos humbet kohë në marrjen e shënimeve

3.14 Në kuadër të politikave të zhvillimit të stafit të parashihet që edhe trajneri të ndjekë trajnime dhe seminare që lidhen me fushën e tij

3.15 Menaxhmenti i Qendrës të hartojë një plan të qartë veprimi për realizimin e të gjitha rekomandimeve të cekura më lart përfshirë objektivat, aktivitetet, personelin e dedikuar dhe afatet kohore për realizimin e tyre.

4. Akreditimi dhe validimi i institucionit/ofruesit është aprovuar me kushtet si në vijim për profilin e Instalues i ngrohjes qëndrore:

4.1 Hartimi i planit të biznesit

4.2 Hartimi i politikave dhe procedurave për proceset e punës që zhvillohen në Qendrën e Trajnimit Diakonia

4.3 Ridizajnimi i kurrikulit, moduleve të trajnimit për kualifikimin e Instaluesit të ngrohjes qendrore

4.4 Hartimi i planit për trajnimin e personelit

4.5 Përshkrimi i vendit të punës për të punësuarit në Qendrën e Trajnimit

4.6 Përgatitja e katalogut të trajnimeve që ofrohen në Qendër

4.7 Përgatitja e plani vjetor për ofrimin e trajnime

4.8 Hartimi i testeve për vlerësim të pjesës praktike

4.9 Zhvillimi i formave për monitorimin e Trajnerëve

4.10 Sigurimi i një hapësire për ruajtjen e materialit shpenzues

4.11 Regjistrimi i hyrje daljes së materialit nga depoja

4.12 Përgatitja e orarit javor të trajnimit për pjesëmarrësit në trajnim

5. Kushtet e parashtruara për aprovim dhe akreditim duhet të përmbushen deri më datën **03.04.2017,** në rastin kur institucioni/ofruesi nuk i përmbushë këto kritere, AKK ka të drejtë tërheqjen e aprovimit dhe akreditimit.

Arsyetim

Në bazë të kërkesës së institucionit/ofruesit dhe rekomandimet të dala nga Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Validimin e kualifikimit, Raporti i Vlerësimit të Panelit të ekspertëve mbi Akreditimin e Institucionit i cili ofron dhe/ose vlereson dhe lëshon kualifikime të aprovuara të cilat rekomandime janë të mbështetura në dëshmi dhe dokumente të ofruara: Aplikacioni për Validim të Kualifikimit/Modulit; Aplikacioni për Akreditim si Institucionit ofrues dhe/ose Vlerësues dhe Lëshues të Kualifikimit; Raporti i Vetë-vlerësimit; Vizita në institucionin/ofruesin aplikues dhe dokumente tjera shtesë, u vendos si në dispozitivin e këtij vendimi.

Këshillë Juridike:
Pala e pakënaqur me vendimin ka drejtë ankese në organet e shkallës së dytë brenda afatit kohor prej 30 ditëve. Ankesa bëhet përmes organit të shkallës së parë.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

7. Vendimi u dërgohet:
   - QT "DTC Diakonie";
   - AKK

Anëtarii i KD së AKK-së
Bedri Xhafa